



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:226209

Datë: 21.02.2022

Numri i dokumentit: 02734492

PKR.nr.170/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për krime të rënda, me gjyqtaren Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M D nga P, për shkak të veprës penale, kultivimi i bimës së hashashit, shkurres, kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 par.1 i KPRK-së dhe për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda, PP/I.nr.196/2021 të datës 26.10.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarit M. D, mbrojtëses së tij av. Zana Krasniqi nga Peja, e caktuar sipas detyrës zyrtare, me datë 09.02.2022 mori dhe shpalli si dhe me datë 21.02.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M. D, i lindur me datë .. në P, me banim në P, rruga “A Gj” nr..., i biri i A dhe i nënës X e gjinisë H, ka të kryer shkollën e mesme, punon si automekanik, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon telefon me numër, identifikohet sipas L. Njoftimit të Lëshuar nga MPB me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës më parë i dënuar .

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Me datë 10.09.2021, në P, në rrugën “A. Gj”, pikërisht në oborrin e shtëpisë së tij, i njëjti pa autorizim ka kultivuar bimën e hashashit me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose, substancave psikotrope, në atë mënyrë që policia gjatë bastisjes dhe kontrollit të shtëpisë së të pandehurit, të njëjtit i gjejnë 1(një) Grinder-Mulli për bluarje të marihuanës, kurse në oborrin e tij gjejnë një bimë të kultivuar në lartësi prej 70 cm, e cila bimë pas ekzaminimit ka rezultuar e llojit kanabis sativa në peshë prej 51.7gram,

- Me çka ka kryer veprë penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurres, kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 par.1 i KPRK-së.

II. Me datë 10.09.2021, në P, në rrugën “A Gj”, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit marihuan, në atë mënyrë që policia afër shtëpisë së të pandehurit ka arritur ta ndalojë të njëjtin, i cili ka qenë duke lëvizur me automjetin e markës „I” ngjyrë të zezë me tabelaku gjatë kontrollit të pandehurit në xhaketën e tij i gjejnë dhe ia sekuestrojnë 2.6 gram bruto substancë të dyshuar narkotike, e ndarë në tri paketime, e cila pas ekzaminimit ka rezultuar e llojit marihuan në peshën neto 2.2 gram,

-Me çka ka kryer veprën penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7,17, 21,38,39, 40,42,43, 69,70, 76, të KPRK-së, dhe nenit 272 par.1, nenit 269 par.1 KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarin e ,

GJYKON

Për veprën penale „kultivimi i bimës së hashashit, shkurre, kokainës ose bimëve të kanabisit” nga neni 272 par.1 i KPRK-së, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Për veprën penale “posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge” nga neni 269 par.1 të KPRK-së të akuzuarit i shqiptohet dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe me dënim gjobë në shumë prej 200€ (dyqind euro).

Gjykata konform nenit 76 par.1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton,

DËNIM UNIK me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 3 (tre) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ,si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 200€ (dyqind euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast të mospagimit të dënimit me gjobë në afat e caktuar, do të zëvendësohet me dënim me burgim, në kohë zgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, ashtu që çdo 20 € (njëzetë) euro të dënimit me gjobë i zëvendësohet me 1 (një) ditë burg.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit kanabis sativa në peshë prej 51.7 gram, si dhe konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuan në peshë prej 2.2 gramë që gjendet në zingjirin e ruajtjes sipas rastit policor nën pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi substanca narkotike e cekur do të shkatërrohet.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore gjykatës ti paguaj shumën prej 25 euro, në emër të paushallit gjyqësor gjykatës të ia paguaj shumën prej 25 €, dhe shumën prej 50 euro në emër të kompensimit për viktimat e krimit, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të rënda ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.196/2021 me datë 26.10.2021, ndaj të akuzuarit M. D nga P, për shkak të veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurre, kokainës ose bimëve të kanabisit, nga neni 272 par.1 i KPRK-së dhe për shkak të veprës penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.09.02.2022, ku i njëjti ka deklaruar se është në gjendje të mirë shëndetësore, nuk ka ndonjë sëmundje psikike, por është i varur nga substanca narkotike dhe ka filluar një program trajtimi vullnetar, andaj gjykata ka vazhduar seancën me që i njëjti deklaroj se mund të vazhdoj shqyrtimin fillestar për çka gjykata ka vazhduar me seancën e shqyrtimit fillestarë ku dhe ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij pasi që në shkresa të lëndës nuk ka prova se i njëjti vuan nga ndonjë sëmundje psikike dhe i njëjti para gjykatës nuk shfaqi ndonjë shenjë të ndonjë çrregullimi psikik. Më pas gjykata e ka njoftuar të akuzuarin me të drejtat e tij dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat dhe e pranon mbrojtësen e caktuar sipas detyrës zyrtare. Më pas shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit PP/I.nr.196/2019 të dt. 26.10.2021 dhe gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se pasi që i ka kuptuar pasojat dhe përpirësit e pranimi të fajësisë të cilat i janë shpjeguar nga ana e Gjykatës, deklaroi se e pranon fajësinë për dy vepra të cilat i vihet në barrë, duke shtuar se pranimin e fajësisë e bëri në mënyrë vullnetare dhe pa u ndikuar nga askush.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se propozon që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare pa presion dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës duke i propozuar gjykatës.

Prokurorja lidhur me rrethana për dënimin ka deklaruar se si rrethana lehtësuese gjykata ta merr parasysh pranimin e fajësisë në të gjitha fazat, pendimin e tij, vendosjen e të njëjtit për të shkuar në trajtim me qëllim të shërimit nga varësia me narkotik, kurse si rrethana rënduese gjykata të merr parasysh se i njëjti është gjykuar më par për vepra të ndryshme penale dhe atë sipas lëndës P.nr.95/18, P.nr.3/13, P.nr.24/2021.

Mbrojtësja e të akuzuarit av.Zana Krasniqi, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i mbrojturi i tij fajësinë për këto vepra të cilat i vihen në barrë qysh në fazën e hetimit me vullnet të lirë i vetëdijshëm për pasojat andaj i propozon Gjykatës që të pranoj një pranim të tillë të fajësisë.

Mbrojtësja lidhur me rrethanat për dënimin ka deklaruar se i mbrojturi i saj në të gjitha fazat dhe në mënyrën më të sigurtë e ka pranuar fajësinë dhe meqenëse i njëjti se ka varësi të rëndë nga substancat narkotike dhe sasia që i është gjetur ka qenë vetëm për nevojat e tij, dhe faktit se i njëjti e ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës dhe pendimin e ka shprehë vullnetin që të trajtohet me qëllim të shërimit dhe të filloi të punoj, andaj gjykata të mbrojturit të saj ti shqiptoj një dënim minimal të paraparë me ligj.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hedhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë

çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti informues i oficerit H.N me nr....-...-... i dt.09.09.2021, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt.09.09.2021, raporti i analizës së narkotikëve dt.14.09.2021, fotoja e substancës narkotike, foto albumi i bastisjes, të dhënat lidhur me të kaluarën e të pandehurit, dhe shkresat tjetra të lëndës, erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se i akuzuari M e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprimet e tij. Si rrethana rënduese gjykata pati parasysh të kaluarën e tij kriminale ku nga evidenca e gjykatës dhe policisë rezulton se i njëjti është dënuar respektivisht dyshuar edhe për vepra penale të llojit të njëjtë dhe të llojit tjetër. Sipas evidencës gjyqësore rezulton se i njëjti ka qenë i dënuar për vepër penale posedim i paautorizuar i narkotikëve nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, sipas aktgjykimit P.nr.266/20 dt.28.07.2020, për vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me par. 1.4 të KPRK-së sipas aktgjykimit P.nr.427/17 të dt.26.11.2018, ka qenë i dënuar për vepër penale kultivim i hashashit, shkures së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 278 par. 1 të KPRK-së sipas aktgjykimit P.nr.95/18 dt.13.03.2018, si dhe ka në zhvillim e sipër procedurën penale sipas aktakuzës PP./I.nr.276/21 të dt.19.01.2021 për vepër penale të mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Në shkresat e lëndës gjykata nuk pati dëshmi se i akuzuari është nën ndikimin e substancave narkotike, por i njëjti këtë e deklaroi në shqyrtim gjyqësor, ku dhe deklaroi se ka filluar trajtimin vullnetarë. Andaj gjykata nuk e vlerësoi si rrethanë lehtësuese pasi që nuk kishte prova këtë.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi me dënim unik të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 272 par.2 dhe 269 par.3 i KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohen substancat narkotike të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe e njëjta pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohet.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPRK-së, e obligoi të akuzuarin ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,**

2021:226209, 21.02.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.